



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës – seanca në orën 10:00. (çështje e shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 15.02.2024 dhe 29.02.2024.)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Emona Muçi*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Irena Plaku*** (anëtare)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)*

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në çështjen e parë, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

7. *Znj. {...}, përfaqësuese e ILD-së.*

8. *{...}, avokate.*

9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës – seanca në orën 10:00. (çështje e shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 15.02.2024 dhe 29.02.2024.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 13 mars.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor sot do kërkohet vendimmarrje për rreth 19 çështje. Sot do zhvillohen dy seanca dëgjimore.

Seanca e parë ka të bëjë me procedimin disiplinor ndaj magjistrates {...} dhe seanca e dytë ka të bëjë me procedimin disiplinor ndaj magjistratit {...}.

Lidhur me seancën e parë nuk është i pranishëm sot zoti Klodian Kurushi, për shkak papajtueshmërie për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore.

Ndërkohë, kjo seancë dëgjimore është shtyrë nga seanca e kaluar lidhur me faktin për të verifikuar tagrat e prokurës së përgjithshme që avokati që përfaqëson subjektin, pra magjistraten, konkretisht avokatja {...}.

Le të thërrasim palët, avokaten dhe Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në qoftë se ka ardhur.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe avokatja znj. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë seancën dëgjimore lidhur me procedimin disiplinor ndaj magjistrates {...}.

Është e pranishme këtu me prokurë të posaçme znj. {...}, më fal, me prokurë të përgjithshme, znj. {...}.

Gjithashtu nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përfaqëson zyrën zonja {...}.

Përpara se të kalojmë në zhvillimin e procedurës, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 29 shkurt 2024, nga ana e Këshillit, avokates së gjyqtares i është përcjellë një njoftim ku i kërkohet që për t'i dhënë mundësi për një mbrojtje sa më efektive, duke i dhënë mundësi për t'u paraqitur vetë dhe në rast se nuk paraqitet vetë, duke autorizuar një person për ta përfaqësuar me një prokurë të posaçme për këtë procedim disiplinor të filluar ndaj saj.

Arsyeja pse Këshilli ju ka bërë këtë njoftim është se në tagrat e prokurës së përgjithshme që ju keni parashtruar nuk janë të shprehura në mënyrë të posaçme dhe konkrete tagrat që keni ju për ta përfaqësuar magjistraten përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu që për këtë arsye Këshilli ju ka njoftuar dhe kërkon që juve të

rregulloni pjesën e aktit të përfaqësimit.

Av. {...}: Unë mendoj që kjo prokurë e përgjithshme në kuptimin tim por edhe të ligjit është një prokurë dhe prokura e përgjithshme e përthith prokurën e posaçme. Gjithsesi unë nuk kam mundur të marrë kontakt - për të qenë në rregull me kërkesën tuaj – nuk kam mund të marrë kontakt me klienten time, kështu që në këtë moment nuk kam prokurë të posaçme. Unë kam prokurë të përgjithshme dhe vazhdoj të jem me këtë prokurë të përgjithshme.

Është në çmimin tuaj ta vlerësoni siç edhe relatuat, që mendoni që unë nuk i kam tagrat me prokurë të përgjithshme. Kështu që kjo është situata.

Naureda Llagami: Nga ana e anëtarëve të Këshillit.

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Unë jam Ilir Rusi, relator i kësaj çështjeje përkatëse.

Në mbledhjen e kaluar të këtij Këshilli, datë 29 shkurt 2024, është gjykuar dhe vlerësuar që kjo prokurë ka vlerë për t’ju njoftuar juve akte apo njoftime përkatëse në lidhje me vijueshmërinë e këtij procedimi disiplinor, sikundër ka ndodhur në këtë moment. Më datë 29 shkurt, ju keni marrë dijeni për këtë seancë dëgjimore. Por edhe klientes apo magjstrates (ju përdorni termin “klientë”, por ajo është magjstrate) i është komunikuar nëpërmjet e-mailit, por nuk ka një përgjigje nëpërmjet postës elektronike. Gjithashtu i është komunikuar tek adresat të cilat janë në dispozicion të Këshillit të Lartë Gjyqësor për zhvillimin e kësaj seance dëgjimore dhe njëkohësisht pajisja me një prokurë të posaçme, nëse nuk ka mundësi të vijë personalisht vetë pranë Këshillit, të autorizohet me prokurë të posaçme një përfaqësues ligjor përkatës. Në këto rrethana është vlerësuar nga ana e Këshillit që ajo prokurë e depozituar deri në këto momente ka një karakter të përgjithshëm dhe në përmbajtje të saj ne mund të bëjmë njoftimin e akteve përkatëse apo edhe njoftimin e zhvillimit të seancave dëgjimore.

Kështu që, meqenëse ju jeni prezent, ne përsërisim kërkesën që të pajiseni me një prokurë të posaçme për këtë procedim disiplinor, duke vlerësuar faktin që ajo prokurë

është lëshuar në muajin maj të vitit 2023 dhe ky (fillimi i procedimit disiplinor) është një fakt i ndodhur në muajin janar të vitit 2024, dhe për shkak të specifikës, qoftë të subjektit në lidhje me atë çfarë përfaqëson si magjistrate, njëkohësisht edhe me specifikat e këtij procedimi disiplinor, është gjykuar nga ana e Këshillit për t'u pajisur me një prokurë të posaçme.

Av.{...}: Atëherë na lini kohë të pajisemi me prokurën e posaçme.

Naureda Llagami: Atëherë, për të qenë më konkretë, sa kohë ju duhet që ju të keni mundësi të kontaktoni me magjistraten për të rregulluar objektin e prokurës.

Av.{...}: Unë mendoj dy javë, sepse në informacionin që kam unë, është e sëmurë. Unë s'kam mundur ta kontaktoj.

Naureda Llagami: Na thoni ju sa kohë ju duhet.

Në qoftë se për dy javë dhe tre javë, vetëm na e thoni, që ne të kemi mundësi...

Av.{...}: Mirë, na lini tre javë që mos të jemi përpara kësaj situate që të shtyhet përsëri.

Naureda Llagami: Atëherë, më datë 11 prill?

Mund ta shohim?

Të pyesim pak edhe zyrën e ILD-së.

Ose 9 prill. Në 9 prill?

Av.{...}: Është Ok!

Naureda Llagami: 9 prill, ora 11:00?!

Atëherë, shtyhet.

Jemi dakord që të gjithë që të shtyhet seanca për t'i lejuar mundësi përfaqësueses

për të rregulluar aktin e përfaqësimit.

Faleminderit!

9 prill ora 11:00.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe avokatja zonja {...}.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Emona Muçi | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Irena Plaku | (anëtare) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 3-ta sipas rendit të ditës.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje z. *Markelian Koça*, ku për arsye teknike nuk është bërë e mundur lidhja.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*

4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

7. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

(Pas disa minutash pushim rifillon mbledhja. Gjithashtu futet në sallën e mbledhjes edhe z. Kurushi i cili nuk ishte i pranishëm në pikën e parë të rendit të ditës.)

Naureda Llagami: Për të vijuar me rendin e ditës.

Fjalën e ka zonja Plaku mbi rendin e ditës.

Irena Plaku: Para se të kalojmë në shqyrtimin e pikëve të tjera, unë kam një propozim që pika 8 e rendit të ditës, pasur parasysh edhe relacionin, të kalojë në një ditë tjetër, ku do shqyrtojmë edhe kandidaturat e tjera për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, pasur parasysh kandidatët të cilët kanë kandiduar nga gjykatat që nuk i përkasin juridiksionit administrativ.

Naureda Llagami: Jemi dakord që ta kalojmë këtë nga rendi i ditës?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë kjo çështje do bashkohet në momentin që vijnë edhe çështjet e tjera nga kandidatët e tjerë në pozicionet vakante në Gjykatën Administrative.

Naureda Llagami: Atëherë, vijojmë sipas rendit të ditës.

Nga administrata njoftohem që zoti magjistrati {...} është paraqitur në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kështu që, ne e kemi parashikuar në orën 11:00, por për efektivitet unë do propozoja që të vijojmë me zotin {...}. Nuk e di nëse nga ana e Zyrës së Inspektorit, kanë ardhur, se jemi përpara?

Akoma!

Atëherë, nëse nuk kanë ardhur nga Zyra e Inspektorit, vijojmë me rendin e ditës, për të plotësuar pjesën që ne kemi.

(Futet në sallën e mbledhjes drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore për të parashtruar relacionin.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Ka ardhur në fakt për ta relatuar drejtorja e Departamentit të Burimeve Njerëzore.

Shkurtimisht, ju e dini që me zgjedhjen e znj. Emona Muçi anëtare e KLGJ-së, ajo nuk mund ta ushtrojë më detyrën si anëtare e Kolegjit Zgjedhor. Kjo e bën Këshillin që të fillojë procedurën për zëvendësimin e saj.

Shkurtimisht lidhur me listat që do jenë, ia jap fjalën drejtores.

Etrita Petriti: Të nderuar!

Në zbatim të ligjit nr. 10019/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 293, datë 09.09.2020 “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”, i ndryshuar, ka miratuar zgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të cilët duhet të jenë gjyqtarë nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatave të apelit, gjykatave administrative të shkallës së parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke përjashtuar vetëm gjyqtarët e Gjykatës kundër Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit.

Ndodhur në kushtet kur zonja Emona Muçi është zgjedhur anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 12.12.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka mbetur me 7 (shtatë) gjyqtarë, duke u krijuar një vakancë.

Nisur nga ky fakt, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor të plotësojë vakancën e krijuar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Pra kriteri bazë që duhet të kenë gjyqtarët është që të kenë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016.

Nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore është përgatitur lista e vënë në dispozicion, ku përfshihen vetëm 85 gjyqtarë të cilët plotësojnë kriteret: pra që ndaj tyre nuk është

filluar një çështje penale; nuk kanë masë disiplinore në fuqi; nuk është filluar procedim disiplinor dhe që nuk janë gjyqtarë në detyrë në Kolegjin Zgjedhor.

Gjithashtu nga lista janë të përjashtuar edhe gjyqtarët të cilët ndonëse kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, janë të komanduar me vendim Këshilli dhe nuk janë aktualisht duke ushtruar funksionin e gjyqtarit; anëtarët e Këshillit nga radhët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit; vi) 4 (katër) gjyqtarët, ish-anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në nenin 146 të ligjit, në pikën 2, përcaktohet se shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor hidhet jo më vonë se 48 orë nga data e përcaktimit të datës së zgjedhjeve me të afërta, sipas këtij ligji. Në të përcaktohet gjithashtu se shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë.

Duke qenë se edhe për vakancën do të zbatohen të njëjtat dispozita si edhe zgjedhjen e anëtarëve, rezulton se pas organizimit të shortit, sipas dispozitës së sipërcituar pika 3 e saj, Këshilli brenda 24 orësh nga hedhja e tij duhet të miratojë me vendim zgjedhjen e gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Anëtari i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor i zgjedhur si më sipër do të ketë mandatin deri në përfundim të mandatit të anëtarëve aktualë të Kolegjit.

Kemi paraqitur përpara jush listën përfundimtare me 85 gjyqtarë të cilët plotësojnë kriteret për t'u përfshirë në këtë listë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse nuk kemi, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

I. Të miratojë listën e gjyqtarëve të cilët përfshihen në shortin për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë: 1. {...} – 85. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga ana e administratës të merren masat që ditën e hënë, datë 18, në orën 11:00 të zhvillohet edhe shorti, seanca publike për hedhjen e shortit, ku të thirren të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e partive politike dhe mediat.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, në gjykatat e të tre niveleve”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje z. *Markelian Koça*, ku për arsye teknike nuk është bërë e mundur lidhja.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Xhevdet Hoxha, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 7. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, në gjykatat e të tre niveleve”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit

(Hyn në sallën e mbledhje Drejtorin e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.)

Naureda Llagami: Atëherë, ftojme Drejtorin e Departamentit të Buxhetit i cili ka për të na relatuar një projekt-akt mbi shpërndarjen e disa pajisjeve të teknologjisë së informacionit, në gjykatat e të tre niveleve, sipas pasqyrës 1, 2. Edhe ky kat vjen si propozim i Komisionit të Administrimit dhe Buxhetit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e pajisjeve dhe sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në KLGJ, pas realizimit të kontratës nr. 4534/28, datë 04.12.2023, me objekt: “Blerje pajisje elektronike, në funksion të plotësimit të nevojave të gjykatave për pajisje IT, të cilat shërbejnë për të realizuar “Upgrade” të infrastrukturës aktuale të sistemit RDA si dhe për të mundësuar regjistrimin audio-video të seancave gjyqësore, ka përgatitur memon e datës 26.02.2024 ku ka kërkuar të kryhet procesi i shpërndarjes të pajisjeve IT, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur.

Gjithashtu me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në korrik të vitit 2023, janë bërë shpërndarjet e disa aktiveve, pajisjeve elektronike dhe të disa aseteve software në gjykatat e të tre niveleve, ku ndër të tjera, është transferuar edhe pajisja Switch Cisco Catalyst 9200 për Gjykatën e Lartë dhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 4276/2, datë 16.01.2024 ka dokumentuar kthimin mbrapsht të kësaj pajisjeje switch të akorduara për këtë gjykatë, pasi nuk i nevojitej për veprimtarinë e saj. Njëkohësisht, Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, nëpërmjet komunikimit elektronik (6 Shkurt 2024) ka evidentuar faktin se pajisja switch Catalyst ka shfaqur probleme dhe në disa raste nuk mundëson qasjen në internet, duke u bërë pengesë për ushtrimin e veprimtarisë së punës në këtë gjykatë.

Në këto kushte vlerësojmë kalimin e pajisjes IT Switch Cisco Catalyst 9200 (me numër serial përkatës) të Gjykatës së Lartë, të kalojë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e shpërndarjes të disa pajisjeve IT nëpër gjykata, sipas pasqyrave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Në s'kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni dhe relatuar nga drejtori.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. Klodiana Veizi të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Emona Muçi** (anëtare)

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5-ta sipas rendit të ditës.

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje z. *Markelian Koça*, ku për arsye teknike nuk është bërë e mundur lidhja.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të

kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm...”.

Naureda Llagami: Me propozim sërish të zonjës Plaku e shtyjmë edhe çështjen e verifikimit dhe plotësimit të kushteve për kandidaten {...}, kur të shqyrtohen edhe të tjera.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e këshillit nr. 239, nr. 244, nr. 247 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje z. *Markelian Koça*, ku për arsye teknike nuk është bërë e mundur lidhja.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e këshillit nr. 239, nr. 244, nr. 247, datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Naureda Llagami: Kalojmë tek {...}.

Fjalën ia jap z. Ridvan Hado mbi verifikimin dhe plotësimin e kushteve.

Shkurtimisht pasi anëtarëve u është vënë në dispozicion relacioni.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me Vendimin nr. 239, nr. 244 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 KLGJ ka vendosur: Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Brenda këtij afati ka kandiduar edhe zonja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Me vendimin nr. 57 është vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e datës 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rezultatet e verifikimit.

Janë verifikuar “përvoja profesionale minimale”. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr. 244 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të sipërcituara, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Nuk rezulton që kandidatja zonja {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

U verifikua gjithashtu edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, referuar nenit 8, pika 5 e ligjit “Për statusin”, kandidatja ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 14.06.2023 nëpërmjet të cilit përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që znj. {...}

të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në mbledhjen e datës 29.02.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të vendimeve të Këshillit nr. 239, nr. 244 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr. 244 dhe nr. 247.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Në s'kemi diskutime kalojmë në votimin e projekt-aktit mbi verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord. Relacioni ishte prezantuar në mënyrë shteruese.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 2-ta sipas rendit të ditës.

9. *Markelian Koça* (anëtar)*
10. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. {...}, gjyqtar.
8. {...}, përfaqësues i ILD-së.
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Naureda Llagami: Duke qenë se ora është 11:03 dhe kemi lënë seancën dëgjimore ndaj magjistratit {...}, nga ana tjetër, njoftohem nga administrata, që si magjistrati ashtu edhe përfaqësueses së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë të pranishëm, kështu që unë do ftoja që ato të akomodohen në sallën tonë të mbledhjes.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së z. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë seancën dëgjimore për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Të pranishëm në këtë seancë është vetë magjistrati z. {...} dhe nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është z. {...}, me detyrë inspektor pranë Zyrës së ILD-së.

Shkurtimisht, lidhur me procedurën, nëse keni kërkesa paraprake, fillimisht duhet t'i parashtroni qoftë edhe kërkesa që lidhen me zhvillimin e procesit, me papajtueshmëritë apo me kërkesat që mund të keni për anëtarë të Këshillit dhe më pas fjala i jepet fillimisht përfaqësuesit të Zyrës së ILD-së dhe më pas fjala i jepet magjistratit, i cili shkurtimisht do shprehet (pavarësisht se i ka parashtruar me shkrim) mbi kundërshtimet që mund të ketë mbi atë që parashtrohet nga zyra e inspektorit. Në përfundim i lihet mundësia anëtarëve të Këshillit të kenë pyetje në vlerësimin e seancës suaj.

Kështu, kemi ndonjë kërkesë paraprake?

{...}: Do doja fillimisht që, është e treta herë që marrë pjesë para Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kam eksperiencë, i njoh procedurat. Jam i nderuar gjithmonë të jem pranë qeverisë së gjyqësorit. Është hera e tretë që unë vij, jo për shkak të shkeljeve që mund të kem bërë, por për shkak edhe të një gjykate që dihet që ka një ngarkesë shumë të madhe, ka problematika, ka ankesa gjithmonë, ka ankesa edhe për shkak të përjashtimit të gjyqtarëve që është bërë si metodë kohët e fundit për të kryer konflikte. Megjithatë, nuk po zgjatem, se kjo i përket themelit.

Unë sapo vij nga një masë që mori KPK-ja për “Shkarkimin nga detyra” që unë s’jam dakord, do ta ankimoj. S’mund të jetë një gjyqtar që punon 46 vjet të ketë burime të paligjshme. Nejse prapë i përket themelit. Kushdo nga ju që mund të ishte në pozitë e mia, një sulm i paparë nga mediat, në tre raste janë videot, para tre vjetësh. Sado i fort të jesh fizikisht, që unë pretendoj që pavarësisht se jam në moshën 65 vjeç, i kam këto kualitetet për të filluar nga e para prapë, por kushdo të ishte, nga ana shpirtërore, jo në gjendje që të merrte pjesë domethënë në dy seanca radhazi. Këto dy çështje, unë bëra edhe kërkesë për ta shtyrë datën e seancës së dëgjimit KPK-ja, duke respektuar qeverinë

e gjyqësorit, por nuk e aprovuan. U vunë në garë me KLGJ-në dhe do caktonin një data para jush, datën 11, në një kohë që e dinin që në datën 13 do ishte seanca përpara jush.

Unë kërkoja pezullimin se e di që duke qenë përbërja edhe me gjyqtarë të nderuar këtu, i dinë shqetësimet e gjyqësorit, aq më tepër të Gjykatës së Vlorës, i dinë shqetësimet mediave që po dalin mbi pushtetin gjyqësor, mundohen të dalin mbi pushtetin gjyqësor. Kohët e fundit edhe pushtetit ekzekutiv gjithashtu mundohet të cenojë pushtetin gjyqësor, sovranitetin e pushtetit gjyqësor. Unë duke pasur parasysh që edhe ligja nuk e lejon që këto dy çështje të bashkohen njëra pas tjetrës, të bashkohet çështja në KPK me çështjen në KLGJ. “De facto” u bashkuan, “de jure” nuk lejohet të bashkohen. Por unë i ka përballuar të dyja. Unë përgatitesha për KLGJ, por bëra përgatitjet edhe për në KPK. Kjo është e padrejtë, është shkelje, është një proces i parregullt ligjor dhe unë do ta kontestoj. Prandaj, unë mendoj se, edhe juve me të drejtë nuk më jeni përgjigjur duke pasur parasysh që doli përpara KPK-ja, është një procedurë e rregullt ligjore, nuk më jeni përgjigjur edhe për provat që duhet të paraqes, sepse shumë nga provat që kam unë (nuk kuptohet fjala: *-me dëshmitarë-*) janë zyrtarë, dhe do kërkoja që edhe duke pasur parasysh ligjin dhe precedentin gjyqësor në raste të tjera që keni pasur, duke qenë se unë pres ta kundërshtoj vendimin e KPK-së, sipas ligjit duhet pezulluar deri në pritjen e përfundimit me vendim të formës së prerë të KPK-së. Unë kam besim se do e kaloj dhe KPK-ja procesin e parregullt ligjor që është bërë nga KPK-ja, duhet ta rrëzojë atë vendim (*KPA-ja*). Jam besimplotë për këtë. Jam besimplotë për të gjitha ato që thashë dhe atje dhe i kam thënë edhe këtu para tek materiali parashtruar. Kam qenë sulm i mediave, bërë nga avokatë të medias që kam çështjet në gjykim akoma të hapura aty. Megjithatë kam besim tek vendimmarrja juaj, por detyrimisht ligji thotë duhet pezulluar.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë ju kërkon që të pezullohet shqyrtimi i çështjes përpara...

{...}: ...deri në përfundimin e vendimit të formës së prerë të KPK-së.

Naureda Llagami: Të KPA-së.

{...}: Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative edhe në precedentin që është krijuar.

Naureda Llagami: Po!

Nga ana e Zyrës së Inspektorit, çfarë qëndrimi keni mbi kërkesën?

{...}: Në lidhje me këtë qëndrim, nuk jam dakord me atë çka parashtrori magjistrati, për shkak sepse procedurat e ndjekura nga KPK-ja apo organet e vetting-ut, nuk mund të pezullojmë procedurat që ndjek ILD-ja apo KLGJ-ja, për sa kohë ato nuk kanë të bëjnë me të njëjtat fakte, pasi procesi i nisur edhe në KLGJ (procedimi disiplinor) ka nisur që në datën 25.02.2024 mbi kërkesën për procedim nisur nga ILD-ja, KLGJ-së, për magjistratin subjekt procedimi disiplinor. Kështu që në këto kushte, jam i mendimit që procesi duhet të vazhdojë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ndonjë pyetje paraprake nga anëtarët përpara se neve të mblidhemi për të vlerësuar kërkesën që bëri magjistrati? Kemi ndonjë pyetje?

Jo!

Ju ftoj që të largoheni nga salla, për të lejuar Këshillin të shprehet mbi kërkesën që parashtrori magjistrati {...}.

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së z. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Fjalën e ka relatori, z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Atëherë, në kushtet kur nga deklarimi i subjektit z. {...} rezulton që sot me vendimin e KPK-së subjekti është shkarkuar, gjithashtu fakt i cili provohet edhe nga faqja

zyrtare e KPK-së. Në kushtet kur ne vendimin nuk e kemi të administruar në dosjen e procedimit disiplinor, do t'i kërkoj mbledhjes së Këshillit shtyrjen e seancës disiplinore, seancës plenare, për të administruar vendimin e shkarkimit të subjektit z. {...}.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë mendim paralel ose mendim të ndryshëm?

Në të kundërt kalojmë në votim propozimin e relatorit.

Klodian Kurushi: Vetëm një shtesë.

Marrja e kopjes së vendimit nga KPK-ja, ne do na vendosi para një fakti të ri, nëse duhet të pezullojmë procesin apo duhet të vijojmë më tej procesin ndaj gjyqtarit magjistrat. Prandaj është e rëndësishme marrja e vendimit të KPK-së.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Po!

Kalojmë në votim propozimin e bërë nga relatori?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Naureda Llagami: Kemi Markelianin “online”. Markelian!

Markelian Koça: Dakord.

Naureda Llagami: Ndjesë Markelian, se tek votimet e tjera nuk patëm mundësi që të lidheshim “online”.

Markelian Koça: Nuk ka problem. Jemi Okej.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, i thërrasim palët për t'i komunikuar vendimin.

(Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së z. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore për magjistratin {...} deri në administrimin e vendimit të Komisionit të Rivlerësimit Kalimtar, dhe seanca shtyhet më datë 9 prill, ora 11:30.

Nuk mund ta shtyjme më shumë sesa 30 ditë.

(Përfaqësuesi i ILD-së flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Nuk keni?! Bëni një autorizim të vijë një person tjetër për atë datë.

Dakord! Faleminderit!

Punë të mbarë!

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së z. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e këshillit nr. 241 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje z. *Markelian Koça*, ku për arsye teknike nuk është bërë e mundur lidhja.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e këshillit nr. 241 datë 24.05.2023 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Naureda Llagami: Viojmë me rendin e ditës.

Sipas rendit kemi verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, të tre prej kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për më shumë detaje fjalën e ka z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimin nr. 241 datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile. Brenda afatit ka kandiduar edhe z. {...}.

Me vendimin nr. 57, datë 07.02.2024 është filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë të kandidatit të sipërcituar.

Nga të dhënat e administruara gjatë verifikimit rezulton se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 241, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar i gjykatës së shkallës së parë.

Gjithashtu, po nga të dhënat e administruara gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Gjithashtu rezulton nga dokumentacioni i administruar si dhe nga vetëdeklarimi i bërë nga zoti {...} se nuk vërtetohet që kandidati të ketë masë disiplinore në fuqi.

Nga verifikimi i papajtueshmërisë ambientale sipas nenit 8, pika 5 të ligjit “Për statusin”, nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati zoti {...} lidhur me situatën e papajtueshmërisë ambientale. Pra z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në mbledhjen e datës 29.02.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit të z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës civile, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të vendimit të Këshillit nr. 241 datë 24.05.2023, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të

vlerësuar dhe vendosur për:

Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 241 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Edhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat ligjore të kandidimit në procesin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatorit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.24, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Emona Muçi** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Irena Plaku** (anëtare)

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës. Pika nr. 8 sipas rendit u shty, shih procesverbalin e pikës 2.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)*</i> |
| <i>10. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.24, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër shkurtimisht, që ka të bëjë me verifikimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për kandidatin z. {...}. Relator z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vakancave në nivele të ndryshme të gjyqësorit. Një përpjekje tjetër është bërë edhe për

gjykatat Tiranë e Durrës nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele të iniciuara. Në rastin konkret për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë hapur pozicionet 23, 24 ndërkohë që për pozicionin nr. 20, pra 20, 23, 24 kandidat ka qenë dhe zoti {...}. Aktualisht zoti {...} është gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i transferuar përkohësisht. Nërkohë që është caktuar në mënyrë të përhershme gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Në kuadër të konkurrimit të tij nga ana e Këshillit janë bërë/kryer disa veprime procedurale. Vlen të theksojmë vendimin nr. 295, datë 30.05.2023 ku është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu vendimi 332, datë 21.06.2023, ku është vendosur: Kualifikimi i z.{...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë në kushtet kur për pozicionin nr. 24 nuk ka kandidatë të kualifikuar me dy vlerësime, me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 është vendosur: Fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim. Këtu figuron edhe z. {...}.

Ndërkohë që janë kryer gjithë këto veprime procedurale, me datën 29.02.2024 kandidati {...} ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 24, datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile.

Ky vullnet është marrë parasysh nga ana e relatorit, pasi kjo situatë është rregulluar nga pika 29 (*pika 59*), seksioni C, Kreu V të vendimit 320/2020 ku përcaktohet se ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.” Dhe në këtë kuadër është përgatitur ky projektvendim

në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.22, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁷

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)

⁷ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)*</i> |
| <i>10. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.22, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që edhe kjo ka të bëjë me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele, për kandidatin {...}. Relator është z. Klodian Kurushi. Shkurtimisht.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Me Vendimet nr.11- nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë

(Tiranë dhe Durrës).

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.22 datë 18.01.2023 kandidoi edhe z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. (aktualisht gjyqtar i transferuar në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan).

Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Me Vendimin nr.295/2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele edhe për pozicionet nr. 22 dhe nr. 23 të vitit 2023 dhe relator për këtë kandidat është caktuar z. {...}.

Më pas, Këshilli, me vendimin nr. 352, datë 06.07.2023, vendosi: Kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin nr. 22.

Më datë 26.02.2024 kandidati z. {...}, me anë të komunikimit elektronik ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin nr. 22 datë 18.01.2023. Kërkesa është pjesë e relacionit.

Përfundimisht, duke tërhequr kërkesën për kandidim, ne si Komision propozojmë përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin nr. 22.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Kurushi!

Kalojmë nëse s’kemi diskutime, në votim të projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.23 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).⁸

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Emona Muçi*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Irena Plaku*** (anëtare)

⁸ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar)* |
| 10. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 11. Yllka Rupa | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.23 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek kërkesa tjetër, për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele, edhe kjo për një gjyqtare, për kandidaten znj. {...} e cila ka hequr dorë nga lëvizja paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës. Për më shumë detaje, fjalën e ka z. Toro.

Alban Toro: Po flasim përsëri për inicimin e procedurave të lëvizjes paralele për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Një nga kandidatet

për këto pozicione të hapura nga 11-24, ka qenë edhe zonja {...}, aktualisht e transferuar me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ndërkohë që ka qenë e caktuar në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Edhe për këtë kandidatë janë bërë disa veprime procedurale.

Fillimisht ajo ka rimodeluar shprehjen e interesit për pozicionet e hapura pasi kandidati konform pikës 5 të nenit 43 nuk mund të kandidonte në më shumë se 3 pozicione të lira, kështu që në përgjigje të komunikimit elektronik të datës 03.02.2023 (*lapsus vitit 2013 që citon z. Toro*), kandidatja ka konfirmuar marrjen e komunikimit duke përcaktuar pozicionin e lirë, konkretisht duke përfshirë edhe nr. 23 datë 18.01.2023.

Edhe për këtë kandidatë janë kryer disa veprime procedurale. Theksojmë vendimin nr. 295, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, ku për të përcaktohet që ka filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023.

Gjithashtu vlejme të theksojmë se me vendimin nr. 351, datë 06.07.2023, ku është vendosur: Kualifikimi i znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 29.02.2029 me anë të komunikimit elektronik kandidatja znj. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 23, datë 18.01.2023.

Në kushtet kur kjo situatë dhe fakti juridik është i rregulluar edhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat”, nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse s’kemi diskutime mbi përmbajtjen.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.247, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).⁹

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹⁰

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. Naureda Llagami

(kryetare)

⁹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

¹⁰ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës dhe relatohet nga zoti Toro. 49

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 2. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 4. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)*</i> |
| 10. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.247, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj.

{...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë dhe në dy aktet e tjera që edhe këto janë për përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë, për kandidaten znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Elbasanit. Për më shumë detaje, për të dy aktet, do të flasë zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë edhe relacioni aktual ka lidhje me dorëheqjen që ka paraqitur kandidatja {...} në lidhje me konkurrimet që ka bërë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 247, si dhe atë në fushën penale të hapur nga ana e Këshillit me vendimin nr. 502, 21.11.2022.

Edhe për këtë kandidate janë kryer disa veprime procedurale. Vlen të përmendim që Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimet nr. 239 – 247.

Gjithashtu në raport me pozicionin e hapur në fushën penale janë kryer përsëri disa veprime procedurale ku vlen të përmendim vendimin 66, 09.02.2023 ku Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; (si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022).

Në fushën e të drejtës penale vlen të përmendim vendimin nr. 268, datë 24.05.2023, ku është vendosur verifikimi i plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 501 dhe nr. 502 datë 21.11.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të

telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore.

Gjithashtu në lidhje me fushën civile ku kjo kandidate ka konkurruar, në datën 08.02.2024 në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit dhe caktimin e relatorit.

Më pas, nga ana e zonjës {...} me postën elektronike të datës 29.02.2024 është paraqitur kërkesa për heqjen dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duke parashtruar se: “Unë gjyqtare {...}, për arsye personale paraqes dorëheqjen time nga kandidimi në pozicionin nr.247, seksioni civil, të shpallur në maj 2023 për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Të njëjtin veprim ka kryer edhe për pozicionin 502 të fushës penale, të shpallur në nga KLGJ në nëntor 2022 për ngritjen në detyrë, ku ajo në datën 03.01.2024 ka paraqitur një kërkesë për heqje dorë e cila përmban: “Unë gjyqtare {...} kërkoj të heq dorë nga aplikimi për pozicionin nr.502, fusha penale, të shpallur nga KLGJ në nëntor 2022 për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për arsye se kam aplikuar për dy pozicione për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur së fundmi nga KLGJ”.

Pra për të dy fushat si civile dhe penale janë paraqitur dorëheqjet të cilat janë fakte juridike të rregulluara tashmë edhe nga aktet nënligjore tonat. Në bazë të këtij rregullimi nga ana e relatorëve përkatës janë përgatitur projektvendimet, në dispozitiv të të cilëve përkatësisht do të gjeni:

-për fushën civile të hapur me vendimin 247, datë 24.05.2023 për këtë kandidate është përgatitur projektvendimi, në dispozitiv të të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 247 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.

{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

E njëjta përmbajtje dhe projektvendim është përgatitur edhe për fushën penale të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit. Të dy projekt-aktet mbi përfundimin e procedurave për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, konkretisht atë të shpallur me vendim nr. 247/2023 dhe nr. 502/2022 për kandidaten znj. {...}.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord për të dyja propozimet.

Naureda Llagami: Dakord për të dyja.

Miratohen.

* * *

(Pikat 11 dhe 12 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).¹¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

- | | |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Emona Muçi | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Irena Plaku | (anëtare) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar)* |

¹¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta sipas rendit të ditës.

10. Gentiana Muçaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç të magjistratit z. {...}”, edhe ky i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga z. Toro).

Alban Toro: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 22.01.2024, është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë, z. {...}, me nr. {...} prot., me objekt kërkesë për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç, referuar nenit 64 pika 5 e ligjit 96/2016. Si shkak të paraqitjes së kërkesës, magjistrati ka parashtruar se më datë 10.09.2024 ai mbush moshën 67 vjeç, moshë për të cilën ai del në pension pleqërie.

Nga të dhënat të cilat disponohen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se me vendimin nr. {...}, datë 24.11.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Me vendimin nr. {...}, datë 25.04.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 20.02.2004 të Presidentit të Republikës, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Me dekretin nr. {...}, datë 25.05.2010 të Presidentit të Republikës, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Nga data 12.12.2018 zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me vendim nr. 581, datë 13.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet mbarimi i mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe rikthehet në pozicion si gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

Vjetërsia siç rezulton është 30 vite dhe nuk ka masa disiplinore.

Kërkesa e z. Bici është bazuar në pikën 5, të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”

Si motiv të qëndrimit në detyrën e gjyqtarit, z. {...} ka parashtuar: “Jam emëruar në detyrën e ndihmësgjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {...}, datë 24.11.1993 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ndërsa me vendimin nr. {...}, datë 25.04.1994 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë jam emëruar në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin nr. {...}, datë 20.02.2004 të Presidentit të Republikës jam emëruar në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, ndërsa me Dekretin nr. {...}, datë 25.05.2010 të Presidentit të Republikës jam emëruar në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë për një mandat 9-

vjeçar, detyrë të cilën jam duke e kryer edhe aktualisht. Pas përfundimit të mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor vijoj të jem gjyqtar në Gjykatën e Lartë për të vazhduar pjesën e mbetur të mandatit, i cili me ka përfunduar më datë 07.07.2022, por në zbatim të nenit 136/5 të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar vazhdoj të qëndroj në këtë funksion (detyrë) deri në caktimin e gjyqtarit pasardhës (zëvendësues).

Me vendimin nr. 168, datë 10.10.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Universitetit të Tiranës kam marrë gradën shkencore “Doktor Shkencash”, me vlerësimin “Shumë mirë” dhe nga data 25.10.2022 jam lektor (me kohë të pjesshme) i të drejtës civile të avancuar dhe të drejtës së punës, pranë “Albanian University” në Tiranë.

Meqenëse jam emëruar në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë përpara ndryshimeve të bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 76/2016 dhe përpara miratimit të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit 64/5 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, duke respektuar edhe afatin 6-mujor që parashikon kjo dispozitë, i drejtohem Këshillit të Lartë Gjyqësor që të më lejojë të vazhdojë të qëndroj në detyrën e gjyqtarit (magjistratit) deri në moshën 70 vjeç.”.

Natyrisht që parashikimet e nenit 64, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, nuk interpretohen në asnjë rast si detyruese për magjistratin, por si lejuese, në kuptimin që pavarësisht moshës së lejuar nga ligji për sigurimet shoqërore për të përfituar pension pleqërie, magjistrati, nëse e vlerëson të nevojshme, mund të qëndrojë në detyrë përtej kësaj moshe, edhe nëse ajo është më e ulët se mosha 67 vjeç, por edhe tej kësaj moshe deri në arritjen e parashikuar si kufiri maksimal moshor për të ushtruar statusin e magjistratit, atë 70 vjeç.

Neni 64 të ligjit të sipërcituar, ka parashikuar se për qëndrimin në detyrë paraqitet një kërkesë jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension, referuar datës së datëlindjes 10.09.1957, (10.09.2024 datë në cilën ai mbush moshën 67 vjeç), përcjellë nga gjyqtari që ka përmbushur afatet e paraqitjes së kërkesës. Ky është një nga kriteret e kërkuara nga ligji.

Vlen të theksohet se Këshilli ka hapur një pozicion të lirë në fushën e të drejtës

penale, për shkak të përfundimit të mandatit të z. {...} të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, procedurë e cila është vijuese.

Më tej pranimi i kërkesës përkon jo vetëm me të drejtën e magjistratit por edhe me vlerësimin që i bën Këshilli në lidhje me situatën juridike e faktike që ndodhet sistemi gjyqësor, pra të nevojave aktuale të këtij sistemi i cili në nivel apeli vuan nga vakanca dhe një ngarkesë të madhe të çështjeve gjyqësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 147 të Kushtetutës ka përgjegjësi jo vetëm për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por ka përgjegjësi për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, kjo e fundit tregues i qartë i përgjegjësi në fushën e statusit të gjyqtarëve.

Në mënyrë të vazhdueshme Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërhyrë në sistemin gjyqësor të Republikës së Shqipërisë me qëllim plotësimin e vakancave të krijuara si pasojë e zbatimit të i Ligjit nr. 84/2016 si edhe normalizimit të ngarkesës së saj detyrim për më tepër i parashikuar nga neni 89 “b” i Ligjit 115/2016. Rasti më i fundit ka qenë caktimi i gjyqtarëve të skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, drejtuesit e së cilës kërkuan ndihmën e Këshillit për normalizimin e situatës nëpërmjet krijimit të trupave gjyqësore të reja në këtë gjykatë.

Megjithëse u përcaktua një hartë e re gjyqësore e miratuar me vendimin nr.495 datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave, përsëri në nivele të caktuara të sistemit gjyqësor rezultojnë të jenë konstatuar një numër i madh i pozicioneve të përhershme si pasojë e pakësimit të trupës gjyqësore duke rritur në mënyrë sproporcionale ngarkesën e konsiderueshme të konflikteve gjyqësore si edhe kohës së madhe që kërkohet për përfundimin e tyre e kompromentuar në këtë mënyrë të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm si një ndër parimet më të rëndësishme të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, (KEDNJ), neni 6.

Një nga Gjykatat në të cilën është verifikuar një panoramë e tillë janë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit të cilat për shkak të ekzistencës së pozicioneve të përkohshme dhe të përhershme të shumta kanë krijuar ngarkesë gjykimesh të konsiderueshme.

Në këtë kuadër, Komisioni, në vështrim edhe të nenit 89 pika b, e Ligjit 115/2016,

duke monitoruar ngarkesën e gjyqtarëve të këtyre gjykatave, kohëzgjatjen e zgjidhjeve të konflikteve gjyqësore si edhe në mënyrë të veçantë numrin e konsiderueshme të tyre, ka arritur në konkluzion që çdo caktim në këtë gjykatë do t'i shërbejë sado pak uljes së ngarkesës.

Nga të dhënat rezulton se, struktura organizative e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është si vijon - Struktura Organizative: 78 gjyqtarë; - Organika në fakt: 33 gjyqtarë; -Efektivisht në detyrë: 26 gjyqtarë, dhe sipas informacionit të përcjellë nga gjykata ka një ngarkesë 38.485 çështjesh. Struktura organizative e Gjykatës Administrative të Apelit është si vijon - Struktura Organizative: 13 gjyqtarë; - Organika në fakt: 8 gjyqtarë; -Efektivisht në detyrë: 11 gjyqtarë, dhe sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata ka një ngarkesë 23.348 çështjesh.

Në këtë kuadër, zgjatja e afatit të daljes në pension, gjatë procesit të përfundimit të funksionit në Gjykatën e Lartë, referuar neni 61, pika 3 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe caktimi i tij pas mbarimit mandatit në pozicion nivel apeli në përputhje me kriteret e kërkuara kjo përkatësisht në përputhje me nenin 61, pika 4 “Për statusin”, i ndryshuar, e cila përcakton se: “Personat e listuar në pikën 1, të këtij neni, kanë të drejtë që pas mbarimit të mandatit të caktohen në një pozicion në nivel apeli.”, do t'i shërbejë përmirësimit të funksionalitetit të gjykatës.

Në këtë kuadër është përgatitur projektvendimi, në dispozitiv të të cilit ju sugjerohet të miratoni.

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e qëndrimit në detyrë të z. Bici deri në moshën 70 vjeç, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 10.09.2024.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, z. {...}, Gjykatës së Lartë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime mbi projekt-aktin, unë propozon të votojmë projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratin z. {...} deri në moshën 70 vjeç, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 3. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 10.09.2024.
 4. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, z. {...}, Gjykatës së Lartë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
- Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Mua më duhet të lëviz për një takim, kështu që vijimi i mbledhjes do vazhdohet nga Zëvendëskryetari, z. Rusi.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-opinionit “Mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar)* |
| 9. Gentiana Muçaj | (anëtare) |

¹² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 15-ta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Priifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe {...} Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projekt-opinionit “Mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, sikundër u bë me dije nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të vazhdojë në drejtimin tim si Zëvendëskryetar i KLGJ-së.

Vazhdojmë me pikën 15 (*i referohet rendit të shpërndarë*) të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projekt-opinionit “Mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 79, germa “b”, dhe 86, germa “d”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 8, 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me bashkë propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 38, datë 31.01.2024 vendosi: “Shpalljen e kërkesës për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për 4 (katër) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, 1 (një) pozicion “Këshilltar” në Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme.”

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim ishte data 14 shkurt.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur kërkesë 3 (tre) kandidatë për pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve dhe 1 (një) kandidat për pozicionin “Këshilltar” në Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme.

Me shkresën nr. 861, datë 07.02.2024, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Zonja {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Me shkresën nr. 944, datë 12.02.2023 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës znj. {...} {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Zonja {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Me shkresën nr. 984, datë 14.02.2023 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Zonja {...} ka

shfaqur gjithashtu vullnetin për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Me shkresën nr. 971, datë 14.02.2023 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës znj. {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Zonja {...} ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin “Këshilltar” në Njësinë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme.

Në vendimin nr. 38, datë 31.01.2024 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar procedura që do të ndiqet nga Këshilli në këtë rast.

Konkretisht, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi është ose jo në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre.

Në pikat vijuese të këtij Kreu, ndër të tjera parashikohet procedura e mëtejshme që ndiqet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. “7. Procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kritereve të përparësisë së kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi sipas pikës 6 të këtij Kreu. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, brenda dy javëve i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku pasqyrohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kritereve të kandidimit përfshirë edhe atyre preferenciale bashkë me renditjen e tyre, duke filluar nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrin e kandidatit të renditur më lart.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për kandidatin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Në rast të mosmiratimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër kandidat që plotëson kriteret e komandimit.

Vlerësimi i Komisionit

Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 38, datë 31.01.2024, në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidon kandidati që ushtron funksionin.

Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton projekt-opinionin për kandidatet: znj. {...}, znj. {...} {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Në përgatitjen e këtij opinionin për këto candidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushtet ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron funksionin gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit.

Fillimisht për znj. {...}

Kriteret e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kriteret e posaçme janë përcaktuar në pikën 3, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 38, datë 31.01.2024. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet ndër të tjera se: “Kriteret e komandimit janë:

- a) Kandidati të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë si gjyqtar;
- b) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- ç) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- d) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
- dh) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.
- e) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe

prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me kriteret e komandimit sipas shkronjave “a”, “b”, “ç” dhe “d”, “dh” të pikës 3, të vendimit të përmendur më lart, sipas informacionit të marrë, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale për këtë kandidate, ka rezultuar se:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

Me vendim nr. 129/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo emërohet gjyqtare.

Me vendim nr. 150/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës si gjyqtare.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, të vitit 2023 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Me vendim nr. 135, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, nga data 01.05.2023 ajo ushtron funksionin si Zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, datë 11.01.2024 rizgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, funksion të cilin ushtron deri në momentin e paraqitjes së kërkesës të bërë në Këshill për komandim.

Lidhur me kriterin e mandatit të kufizuar, sipas germës “c”, kandidatja ka vënë në dijeni Këshillin më datë 23.02.2024 se ka hequr dorë nga pozicioni i zëvendëskryetares. Në komunikimin elektronik të datës 07.03.2024, znj. {...} ka bërë me dije Këshillin se në datën 13.03.2024 (pra ditën e sotme) është planifikuar mbledhja e gjyqtarëve për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të ri të gjykatës.

Lidhur me kriteret e komandimit - kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale – znj. {...} ka nënshkruar vetëdeklarimin datë 07.02.2024 sipas të cilit ajo deklaron: “Nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë

ambientale”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga znj. {...} dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi dhe plotëson kriteret specifike të kërkuara nga Këshilli për këtë kandidatë.

Në lidhje me kandidaten znj. {...} {...}.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit – janë të njëjta dhe nuk po i përmend më, sikundër i përmenda për zonjën {...}.

Lidhur me kriteret e komandimit sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, “dh” të pikës 3, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se:

Znj. {...} {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendimin nr. 476, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo emërohet gjyqtare.

Me vendimin nr. 511, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo caktohet në pozicion si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me kriteret e komandimit - kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale – znj. {...} ka deklaruar përpara Këshillit se: “Nuk ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatja dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Në këto kushte, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi

dhe plotësohen kriteret specifike të kërkuara nga Këshilli.

Për zonjën {...}

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, janë ato të përcaktuara në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin” si dhe në Vendimit të Këshillit nr. 38, datë 31.01.2024, të përmendura edhe më lart në rastin e znj. {...} dhe unë nuk po i përsëris.

Në lidhje me kriteret e komandimit sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, “dh” të pikës 3, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidates, ka rezultuar se:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 12.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendimin nr. 483, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo emërohet gjyqtare.

Me vendimin nr. 505, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me vendimin nr. 134, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Me vendimin nr. 525, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrrojë këtë funksion pranë kësaj gjykate.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me kriteret e komandimit – kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale – znj. {...} ka vetëdeklaruar më datë 14.02.2024 se: “Nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatja znj. {...} dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi nga ato që ne përmendëm më lart për këtë kandidatë.

Kandidatja {...}.

Edhe për zonjën {...}, në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, të parashikuara në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin” si dhe në Vendimin e Këshillit nr. 38, datë 31.01.2024, janë ato të cilat unë i kam përmendur më lart. Janë të njëjtat kritere ndaluese.

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 18.07.2011, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E Drejtë civile”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2013 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendimin nr. 473, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ajo emërohet gjyqtare.

Me vendimin nr. 503, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Me vendimin nr. 130, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku dhe aktualisht ajo ushtron funksionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me kriteret e komandimit – ky kandidat nuk ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale sipas deklaratës së paraqitur prej saj referuar parashikimeve të nenit 8 pika 1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatja dhe dokumentet e tjera që ndodhen në dosjen personale, rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të

gjykatës.

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, kjo analizë bëhet duke marrë në konsideratë raportimet periodike dhe informacionet e përcjella për ngarkesën, si edhe mendimin e marrë nga zëvendëskryetarët e gjykatave respektive:

Për znj. {...} është përcjellë opinionin duke u parashtruar se:

“...Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është miratuar në strukturën organike një numër prej 7 (shtatë) gjyqtarësh dhe aktualisht ushtrojnë funksionin 5 (pesë) të tillë duke përfshirë edhe znj. {...}.

Ngarkesa aktuale e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës më datë 20.02.2024 ku janë marrë materialet për të përgatitur këtë relacion, rezulton se zonja {...} (ndërmjet të tjerave tabela është për të gjithë fazat, por unë po përmend atë çfarë na intereson më tepër), pra aktualisht ajo na në shqyrtim 103 dosje në dorë.

Duke konsideruar ngarkesën aktuale prej rreth gjithsej 640 çështje në gjykim, duhet theksuar se ulja e numrit të gjyqtarëve efektiv nga 5, në 4 gjyqtarë, nuk do të ketë efekt negativ në performancën e gjykatës, -thekson zëvendëskryetarja e gjykatës, pra vlerësoj se, nuk dëmtohen interesat e kësaj gjykate në drejtim të funksionalitetit të saj, nga komandimi i gjyqtares znj. {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ngarkesa e gjykatës mund të menaxhohet, duke mbajtur në konsideratë se organika prej 7 gjyqtarësh e gjykatës do të plotësohet edhe me emërimin e magjistratëve të rinj.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë qëllimin e komandimit pranë KLGJ, si dhe rrethanat profesionale dhe familjare të gjyqtares, mendoj se komandimi nga ana e Këshillit, nuk do të sillte cenimin e funksionalitetit të gjykatës.

Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka përcjellë opinionin për znj. {...} {...}, si më poshtë:

“...Lidhur me informacionin që keni kërkuar, sqarojmë se gjyqtarja {...} është emëruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në datën 20.10.2020. Që nga ajo datë e deri aktualisht, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pa

ndërprerje në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Me urdhrin e datës 04.11.2013 të Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, është vendosur shkrirja e dhomave civile dhe penale në një dhomë të vetme. Si rrjedhim, gjatë kësaj periudhe, gjyqtarja {...} ka gjykuar çështje civile dhe penale, dhe po kështu ka gjykuar edhe në seksionin për gjykimin e çështjeve penale me të mitur.

Ju vë në dijeni të faktit se aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka në organikë të saj 8 gjyqtarë, ku ushtrojnë efektivisht detyrën 5 gjyqtarë, përfshirë dhe znj. {...}.

Për sa i përket komandimit të gjyqtares, efekte negative do të pasqyrohen vetëm në shpërndarjen e dosjeve të saj, ku aktualisht ka 413 dosje, duke pasur parasysh faktin që edhe gjyqtare {...} është shtatzënë dhe pas lindjes së saj mbeten 3 gjyqtarë efektivë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Efekti tjetër negativ do të ishte në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit të dosjeve, ku aktualisht gjyqtarja znj. {...} ka në gjykim e sipër, pra të papezulluara, dosje civile e penale që nga viti 2020-2021.

Për sa më sipër, përpos efekteve negative të shpjeguara më sipër, që mund të ketë komandimi i gjyqtares znj. {...} në këto momente nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, lë në çmim lë Këshillit të Lartë Gjyqësor vendimin lidhur me komandimin e saj.” Kjo është përgjigjja e sjellë nga Gjykata e Beratit.

Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka përcjellë opinionin për aplikimin e znj. {...}. Në opinionin e saj janë përfshirë edhe 2 gjyqtare të tjera përkatësisht znj. {...} dhe znj. {...} të cilat kanë aplikuar për pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, si më poshtë:

“... Në përgjigje të kërkesës për dhënie mendimi ju bëj me dije se, magjistratet znj. {...} dhe znj. {...} janë pjesë e seksionit civil të Gjykatës Elbasan, e cila aktualisht ka 5 gjyqtarë, sepse një gjyqtare është me leje lindje. Nëse do të komandoheshin të dyja gjyqtaret atëherë vlerësoj se do të cenohej funksionaliteti i gjykatës. Gjykatë e cila ka qenë pothuajse në gjendje kolapsi për shkak se në shtator 2023 mbeti me tre gjyqtarë.

Komandimi i tyre do të na detyronte të shkrimin seksionet dhe mbi të gjitha

gjqtarët do të mbingarkoheshin me dosje. Ju bëj me dije që jemi nën presion të vazhdueshëm të publikut, mediatik, por dhe të institucioneve për shkak të vonesave në gjykim dhe arsyetim. Mendoj që komandimi i njëres apo të dyja gjyqtareve përkatësisht në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese do të cenonte funksionalitetin e Gjykatës Elbasan, të cilës edhe aktualisht i mungojnë në organikë 5 gjyqtarë.

Në lidhje me gjyqtaren znj. {...} ju bej me dije se gjyqtarja znj. {...} i përket seksionit penal. Mesa jam në dijeni është në proces plotësimi i një vendi vakant në Gjykatën Elbasan në fushën penale. Ndonëse ngarkesë kemi edhe në seksionin penal, nëse paralelisht me komandimin e gjyqtares znj. {...} do të plotësohej vakanca në gjykatë që është në proces komandimi i saj në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nuk do të cenonte funksionalitetin e gjykatës.

I kërkoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që të mbajë në vëmendje gjendjen në të cilin ndodhet Gjykata e Elbasanit për shkak të ngarkesës, por edhe pozitën e gjyqtarëve të cilët ushtrojnë detyrën në këtë gjykatë prej vitesh, përpara se të vendosë për komandime të gjyqtarëve të kësaj gjykatë në gjykatat më ta larta.”

Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka përcjellë opinionin për aplikimin e znj. {...}.

“Me përgjigje nëpërmjet postës elektronike të datës 20.02.2022 të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i është kërkuar informacion nëse ka ose jo cenim të interesave të larta të kësaj gjykatë në drejtim të funksionalitetit të saj, në rast hipotetik të komandimit të Gjyqtares Znj. {...}, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bëj me dije se me implementimin e hartës së re gjyqësore, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka një organikë prej 23 gjyqtarësh. Aktualisht, në këtë gjykatë ushtrojnë detyrën vetëm 11 prej tyre, përfshirë edhe Zv/Kryetarin e Gjykatës. Me vendim të Këshillit të Gjykatës është bërë ndarja në dhoma dhe seksione. Pavarësisht numrit aktual të gjyqtarëve, vijon që dhomat e seksionet të jenë të tilla. Zonja {...} është caktuar me vendim të Këshillit të Gjykatës pjesë e seksionit civil në këtë gjykatë, ku vazhdon të ushtrojë funksionet aktualisht. Gjyqtarja ka në shqyrtim mbi 600 çështjeje, ndërsa seksioni ku ajo bën pjesë është me vetëm 5 gjyqtarë.

Duke pasur në konsideratë edhe nevojat që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka për gjyqtarë të komanduar, pas prezantimit të faktit si më sipër, atë e lë në çmim të Këshillit. Në rast të miratimit të kërkesës së znj. {...}, do lutesha që të procedohej me një mënyrë më të shpejtë për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në këtë gjykatë. Ngarkesa vijon të mbetet e lartë, në raport me gjyqtarët aktual.”

Komisioni për të analizuar funksionalitetin e gjykatave ka marrë të dhëna edhe ngarkesën përkatëse të gjykatave, të përcjellë nga gjykatat pranë sektorit të Statistikave dhe Arkivës Gjyqësore në Këshill.

Tabelat janë të integruara në këtë relacion.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

Evidentojmë se gjyqtarja {...} aktualisht ka në shqyrtim 415 çështje. Ndërsa gjyqtarët e tjerë janë {...}, 229, {...}, 199, {...}, 129, {...}, 192 çështje.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Gjyqtarja {...} ka në gjykim 500 çështje. Gjyqtarët e tjerë kanë në gjykim, z. {...} 315, z. {...} 468, znj. {...} 483, znj. {...} 495, z. {...} 511, z. {...} 408, znj. {...} 486, z. {...} 497, znj. {...} 237, znj. {...} 188 çështje.

Vijojmë më tej, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan: znj. {...}, ka gjithsej 505 çështje në shqyrtim. Znj. {...}, që është edhe kjo kandidate për t’u përfshirë në skemën e komandimit, ka gjithsej 331 çështje në shqyrtim. Znj. {...}, ka gjithsej 322 çështje në shqyrtim. Ndërkohë, ngarkesa për gjyqtarët e tjerë vijon si më poshtë: znj. {...}, 316 çështje, znj. {...}, 378 çështje, z. {...}, 438 çështje, znj. {...}, 499 çështje, z. {...}, 510 çështje, znj. {...}, 333 çështje, z. {...}, 321, z. {...}, 380.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës: ngarkesa e gjyqtarëve për çështjet që kanë në vijim vijon si më poshtë: znj. {...}, që ka shfaqur interesin e saj për t’u përfshirë në skemën e komandimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka gjithsej në shqyrtim 103, znj. {...}, ka 165, znj. {...}, 166, z. {...}, 138, znj. {...}, 67 çështje, z. {...} i caktuar për gjykimin e 1 çështjeje ka gjithsej 1 çështje në gjykim.

Në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate. Në këtë

përfundim në arrijmë duke marrë në konsideratë: i) ngarkesën e çështjeve që ka kjo gjykatë (gjithsej 640 çështje); ii) numrin aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht pranë gjykatës respektive ku tashmë është rikthyer në këtë gjykatë edhe z. {...} (6 gjyqtarë) kur organika e kësaj gjykate është 7, funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet. Pra nëse ne marrim një gjyqtare dhe e bëjmë pjesë të komandimit, ngarkesa do të shpërndahet edhe me një gjyqtar të ri që ka hyrë rishtazi në gjykatën e Kukësit që është gjyqtari {...}.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate, për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet po me këto kushte që ne po i përmendim tani në këtë projekt-opinion. Duke marrë në konsideratë: i) ngarkesën e çështjeve që ka kjo gjykatë (1265 çështje); ii) numrin aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë gjykatës (5 gjyqtarë) dhe në eventualitetin e komandimit të znj. {...} do të funksionojë me 4 (katër) gjyqtarë. Opinioni i zëvendëskryetares së gjykatës ka vë në dukje një ngarkesë të lartë të gjyqtares në këtë gjykatë, merret në konsideratë nga ana e komisionit dhe për këtë pikë dhe për këtë rrethanë Komisioni propozon që në eventualitetin e kalimit me sukses të fazës vijuese në KVEVP, rendimenti i znj. {...} në përfundimin e çështjeve të ngarkuara për t'u shqyrtuar prej saj, duhet të merret në konsideratë lidhur me datën e efekteve juridike të komandimit. Pra ne duhet të përcaktojmë në fund fare nëse do të kalojë me sukses, rendimenti që duhet të heqë zonja {...} me datën e fillimit të komandimit të saj pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (pra nëse kalohet me sukses pjesa tjetër e fazës vijuese që duhet të procedohet nga Komisioni etik dhe i veprimtarisë profesionale.

Sa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, situata është më komplekse. Nga kjo gjykatë kanë aplikuar për komandim 3 (tre) gjyqtare: znj. {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Këshill; znj. {...}, për pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë; znj. {...} e cila ka aplikuar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese. Në këto rrethana mbajtur në vëmendje numrin e gjyqtarëve që ushtrojnë aktualisht funksionin në këtë gjykatë (11 nga 18 që janë në strukturën e kësaj gjykate), mundësohet komandimi vetëm për 1 (një)

magjistrat. Pra mund të marrim nga Gjykata e Elbasanit një magjistrat për ta komanduar në pozicionet që ne kemi hapur. Për të përcaktuar magjistratin dhe pozicionin ku ai duhet të komandohet, komandimi i të cilit prek më lehtë funksionalitetin e gjykatës, Komisioni merr në analizën ngarkesën e secilit magjistrat dhe natyrën e çështjeve që ka në shqyrtim. Znj. {...} është pjesë e seksionit penal dhe ka në shqyrtim 505 çështje; znj. {...} është pjesë e seksionit civil dhe ka në shqyrtim 322 çështje; znj. {...} është pjesë e seksionit civil dhe ka në shqyrtim 331 çështje. Nga këto statistika rezulton se ngarkesa e znj. {...} është dukshëm shumë më e lartë krahasuar me dy magjistratët e tjera; nga ana tjetër znj. {...} është pjesë e seksionit penal, ku gjykon çështje me karakter urgjent e tepër urgjent. Siç parashtron edhe zëvendëskryetarja e gjykatës për një pozicion të lirë të shpallur për lëvizje paralele në fushën penale, (pozicioni nr.252/2023) procedurat mund të përfundojnë shpejt nga ana e Këshillit. Bëhet fjalë për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, që ne jemi në fazën e vlerësimit pasi mbetet një kandidate e vetme në atë pozicion (një kandidate e vetme e cila ushtron funksionin e saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër), kështu që ajo mbetet e vetme dhe nëse do të fusim në skemën e komandimit një gjyqtare, duhet të përshpejtojmë procedurat për të sjellë atë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Përgjithshëm Elbasan. Në eventualitetin e komandimit të znj. {...}, zëvendësimi i gjyqtarit në çështjet penale mund të sjellë pasoja për procesin, sa i përket afateve të paraburgimit, ashtu edhe në drejtim të zgjatjes së afatit të afatit të arsyeshëm, aq më tepër kur në çështjet penale preken të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Për sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...}, do të passjell cenim të interesave të larta të gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për sa kohë funksionaliteti i saj do të dëmtohet, nisur nga numri i gjyqtarëve si dhe nga ngarkesa personale e çështjeve që ka në ngarkim secili nga tre gjyqtarët që ka shfaqur interesin për t'u futur në skemën e komandimit. Ndër dy magjistratet e tjera të cilat kanë aplikuar për komandim në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, vërehet se znj. {...}, pjesë e seksionit civil ka ngarkesë më të ulët, në krahasim me dy koleget e tjera, që edhe ato kanë shprehur interesin për t'u përfshirë në skemën e komandimit, e për pasojë komandimi i saj nuk do të dëmtonte interesat e Gjykatës së Shkallës së

Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Duke marrë në konsideratë faktin që ne mund të sjellim një gjyqtar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në Gjykatën e Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nuk passjell cenim të interesave të larta të gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet, për arsye se: për këtë gjykatë Këshilli ka në proces përfundimin e procedurës për lëvizjes paralele për 3(tre) pozicione të lira të shpallura vitin e kaluar (vendimet nr. 22, 23 dhe 24/2023) dhe potencialisht shumë shpejt do të ushtrojnë funksionin në këtë gjykatë edhe 2 (dy) gjyqtarë të tjerë; gjithashtu Këshilli ka nisur procedurat e lëvizjeve paralele të shpallura me vendimet nr. 82-86/2024 për 5 (pesë) pozicione të tjera të lira. Për vendet e hapura me vendimet e Këshillit të vitit 2023, një kandidatë është e vetme në pozicionin nr. 23. Ajo është e kualifikuar dhe pret vetëm një vlerësim nga Këshilli. Kështu që potencialisht, duke qenë e vetme në garë, ne mund të përdorim skemën e transferimit vetëm për atë gjyqtare, për sa kohë ajo është e vetme në atë pozicion. Dhe mendojmë që në momentin kur nëse do përfundojë me sukses procedura e komandimit për gjyqtaren {...}, në të njëjtën kohë ne mendojmë të vëmë në lëvizje mekanizmin e transferimit të përkohshëm për të bërë zëvendësimin e gjyqtares që mund të kalojë me sukses procedurën e komandimit me gjyqtaren që normalisht sipas parashikimit tonë, mund të vijë me transferim të përkohshëm të dedikuar, në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës. Pra në këtë pikë, themi që nuk dëmtojmë funksionalitetin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke bërë një zëvendësim të menjëhershëm të gjyqtarit, atë që përfshihet në skemë komandimi me gjyqtarin që do të transferohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Kandidatet që kanë aplikuar për komandim në Këshill, vihet re se kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira të shpallura me vendimet 73-86/2024. Ne kemi evidentuar dy raste të cilat mund të plotësojnë kushtet për të vijuar shumë shpejt procedurat e kualifikimit dhe të transferimit të tyre nëpërmjet lëvizjes paralele.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjatë fazës vijuese, nga KVEVP të mbahet në vëmendje edhe kushti i parashikuar në vendimin nr.38/2024 për konfliktin e interesit: “Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit: “...f) për shkak të konfliktit të interesit që mund të gjendet gjatë ushtrimit të funksionit në pozicionin si magjistrat i komanduar”. Pra ne propozojmë që në atë fazë kandidatët nëse do ta kalojnë këtë fazë, duhet të paraqesin së paku një deklaratë që me pranimin e tyre në pozicionin e komandimit në KLGJ, ato duhet të paraqesin një deklaratë për të shmangur konfliktin e interesit për shkak të kërkesave që ato kanë bërë në lëvizje paralele në gjykatat respektive Tiranë ose Durrës.

Për sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Vijimin e procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidatët gjyqtarë: znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

2. Përfundimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për shkak se komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ajo ushtron funksionin e saj.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-opinionit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas relacionit dhe relatimit të bërë nga zoti Kurushi.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Emona Muçi** (anëtare)
5. **Ridvan Hado** (anëtar)
6. **Irena Plaku** (anëtare)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Markelian Koça** (anëtar)*

¹³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 16-ta sipas rendit të ditës.

9. Gentiana Muçaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t’u komanduar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Nëse kolegët janë dakord për të kaluar në mënyrë të përmbledhur rezultatet e

relacionit për zonjën {...} për shkak se një pjesë e argumenteve që ne i parashtruam në relacionin që sapo shoqëroi edhe projekt-opinionin e miratuar, është përshirë edhe argumentimi i arsyeve pse duhet të përfshihet në skemën e komandimit dhe duhet t'i japim një opinion pozitiv znj. {...}. Kështu që, nëse kolegët bien dakord, mund të kalojmë në pjesën e fundit.

Atëherë, janë të njëjtat argumente siç i përmendëm në relacionin pararendës, kështu që përfundimisht për zonjën {...} ne paraqesim një opinion pozitiv dhe i propozojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor t'i dërgohet Gjykatës së Lartë emri i zonjës {...} e cili ka aplikuar për t'u komanduar, "ndihmësmagjistrat" në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, si dhe praktika dokumentare e paraqitur prej saj.

Publikimin e këtij opinionimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim propozojmë që të hyjë në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka propozime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për dërgimin e emrit të kandidatit i cili ka aplikuar për t'u komanduar në pozicionin "ndihmësmagjistrat" në Gjykatën e Lartë".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. T'i dërgohet Gjykatës së Lartë emri i znj. {...}, e cila ka aplikuar për t'u komanduar, "ndihmësmagjistrat" në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, si dhe praktika dokumentare e paraqitur prej saj.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Emona Muçi** (anëtare)
5. **Ridvan Hado** (anëtar)
6. **Irena Plaku** (anëtare)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Markelian Koça** (anëtar)*

¹⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 17-ta sipas rendit të ditës.

9. Gentiana Muçaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.

6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përjashtimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Me vendimin nr. 69, datë 15.02.2024 Këshilli vendosi: “1. Rishpalljen e kërkesës

për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Kushtetuese për 2 (dy) pozicione “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese.

Afati i paraqitjes së kërkesave ishte deri në datën 01.03.2024.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur vetëm një kërkesë e vetme. Kërkesa është paraqitur më datë 01.03.2024 nga gjyqtarja {...}, e cili ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në vendimin nr. 69, datë 15.02.2024 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli. Nuk po e lexoj.

Vlerësimi i Komisionit

Është procedura e parashikuar dhe në vendimmarrjen që ka marrë Këshilli për hapjen e vendit përkatës në skemën e komandimit.

Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 69, datë 15.02.2024 të Këshillit, në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, si edhe verifikohen kushteve dhe kriteret e tjera të komandimit.

i. Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit.

Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 dhe janë të integruara në pjesën e relacionit.

Lidhur me kushtet për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi nga ato që ne i përmendëm në vendimin e sipërcituar.

ii. Në lidhje me kriteret e veçanta

Sa i përket kriterëve të veçanta, në vendimin nr.69, datë 15.02.2024 është parashikuar se: Kriteret preferenciale të komandimit:

a) Përvoja profesionale minimale prej 1 (një) viti dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;

b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;

c) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

ç) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;

d) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsyetimit ligjor;

dh) Aftësi shumë të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë;

e) Specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut.

Nga të dhënat e marra nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, rezultoi se znj. {...} është caktuar në pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin nr. 593/2023. Kjo kandidatë ka 4 (katër) muaj vjetërsi në detyrë. Institucioni kërkues që është Gjykata Kushtetuese, në shkresën drejtuar Këshillit për kriteret preferenciale ka përcaktuar: “Përvojë profesionale minimale prej 1 (një) viti”. Nga sa më sipër, rezulton se kandidatja znj. {...} nuk plotëson kriterin preferencial të kërkuar nga Gjykata Kushtetuese.

Komisioni çmon të theksojë se, edhe në rast se do të përmbusheshin kriteret e veçanta, për të këtë kandidatë, komandimi i saj do të ishte i pamundur pasi, siç e përmendëm edhe në relacionin pararendës, cenohet funksionaliteti i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mendimi i është marrë zëvendëskryetares së kësaj gjykate, të cilin unë e përmenda në relacionin pararendës dhe nuk po e përsëris.

Edhe ngarkesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për numrin e çështjeve, unë e përmenda më parë.

Po vijoj në fund me vlerësimet dhe konsideratat e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Sa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, situata është komplekse. Nga kjo gjykatë kanë aplikuar për komandim 3 (tre) gjyqtare: znj. {...}, për pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë; znj. {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Këshill dhe znj. {...} e cila ka aplikuar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese. Në këto rrethana mbajtur në

vëmendje numrin e gjyqtarëve që ushtrojnë aktualisht funksionin në këtë gjykatë (11 nga 18 që ka struktura), mundësohet komandimi vetëm për 1(një) magjistrat. Për të përcaktuar magjistratin, komandimi i të cilit prek më lehtë ose aspak funksionalitetin e gjykatës, Komisioni merr në analizën ngarkesën e secilit magjistrat dhe natyrën e çështjeve që ka në shqyrtim. Znj. {...} është pjesë e seksionit civil dhe ka në shqyrtim 322 çështje; znj. {...} është pjesë e seksionit penal dhe ka në shqyrtim 505 çështje; znj. {...} është pjesë e seksionit civil dhe ka në shqyrtim 331 çështje. Nga këto statistika rezulton se ngarkesa e znj. {...} është më e ulët se koleget e tjera që kanë kandiduar për komandime. Siç parashtron edhe zëvendëskryetarja e gjykatës për një pozicion të lirë të shpallur për lëvizje paralele në fushën penale, (pozicioni nr.252/2023) procedurat mund të përfundojnë shpejt nga ana e Këshillit. Por, në eventualitetin e komandimit të znj. {...} (e përmendëm edhe më lart) zëvendësimi i gjyqtarit në çështjet penale mund të sjellë pasoja për procesin, sa i përket afateve të paraburgimit, ashtu edhe në drejtim të zgjatjes së afatit të arsyeshëm të përfundimit të një çështjeje penale. Për sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...}, do të passjellë cenim të interesave të larta të gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për sa kohë funksionaliteti i saj do të dëmtohet. Ndër dy magjistratet e tjera të cilat kanë aplikuar për komandim në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, vërehet se znj. {...}, pjesë e seksionit civil ka ngarkesë më të ulët, e për pasojë komandimi i saj nuk do të dëmtonte interesat e Gjykatës së Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë:

1. Përfundimin e kandidatës znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese. (për shkak të dy kritereve që thamë: nuk plotëson kriteret specifike, sepse nuk ka përvojën prej 1 viti si përvojë profesionale në detyrë dhe nga ana tjetër do të dëmtonte dhe cenonte funksionalitetin e gjykatës nëse ne do të komandonim dy gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan).

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përjashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese.

2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 17 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Emona Muçi | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Irena Plaku | (anëtare) |

¹⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 18-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|--------------------------|------------------|
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)*</i> |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
- 6. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

17. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në mbledhjen plenare të datës 20.02.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, me vendimet nr. 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85 dhe 86, datë 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.03.2023.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 39 (tridhjetë e nëntë) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira në fushën civile e penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe 20 (njëzet) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira fushën civile e penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës të prezantuar si më sipër.

II. Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës të shpallura me vendimet nr. 73- nr. 86, datë 20.02.2024 Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”. Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e përmendura më

lart.

“IV. Procedura e lëvizjes paralele

Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit;

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij vendimi.

Këshilli, me vendimin e datës 11.03.2024 vendosi: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73 – nr. 86, datë 20.02.2024, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi”. Shtojca ka listën (unë s’po e përmend tani) se kush ka dhe kush mund të ketë dy vlerësime, lista e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim dhe lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund t’u bëhet një vlerësim.

Në përputhje me pikën 9 të vendimeve, nr. 73 - nr. 86 datë 20.02.2024, si dhe referuar vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e mësipërme, fillimisht për kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

Sa i përket listës së këtyre kandidatëve, sa i përket kandidatit z. {...}, siç rezulton edhe nga prezantimi në shtojcë ai është aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ne e kemi transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Kërkesa e tij për transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele bie (sipas mendimit tonë) në kundërshtim me parimet dhe kuptimin e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele sipas parashikimeve të nenit 42 e 43 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si edhe rregullores 320/2020, për arsyet që do të argumentohen më poshtë:

Kuptimi i transferimit jepet në nenin 42 të Ligjit 96/2016. Sipas parimeve të transferimit të parashikuara në këtë nen, vërehet se 1. “Transferimi” është: a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel;

Zoti {...} ka kandiduar për t’u transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në pozicionin 81 të fushës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke qenë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i cili e ushtron funksionin aktualisht në seksionin civil të kësaj gjykate. Pra z. {...} (sipas mendimit tonë) nuk ndodhet në kushtet e germës “a” të Nenit 42 të Ligjit 96/2016 për të lëvizur në një gjykatë tjetër pasi është pjesë e të njëjtës gjykatë. Ndërsa në germën “dh” të pikës 6 të rregullores 320/2020 përcaktohet i njëjti kriter ligjor (nuk po e përmend, është i parashikuar në relacion). Kandidimi i z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, seksioni civil për në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, seksioni penal nuk mund të jetë objekt i lëvizjes paralele dhe të rregullohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Lidhur me znj. {...} {...}, gjyqtare e cila mund të ketë 2 (dy) vlerësime, Komisioni propozon se për këtë kandidate nuk mund të fillojë procedura e verifikimit për lëvizjen paralele pasi kjo gjyqtare (sipas mendimit tonë) nuk ka aplikime të vlefshme.

Këshilli ka verifikuar kriteret formale për kandidaten znj. {...} për pozicionet nr. 500/2022 dhe nr. 501/2022 për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; këto dy aplikime znj. {...} i ka ende në proces;

gjithashtu znj. {...} ka aplikuar edhe për pozicionin nr. 246/2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe këtë aplikim e ka ende në procedurë pasi është duke u verifikuar për kriteret formale. Pra zonja {...} ka tre aplikime që janë në proces në KLGJ, dy për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe një për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në një pozicion civil.

Neni 43/5 i Ligjit 96/2016 parashikon se: “Pas shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces (dhe ne konstatojmë që ajo i ka tre procedura në proces), kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.” Ndërsa Neni 48/6 i ligjit për statusin parashikon se: “Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. *(ripërsëritet paragrafi neni 43/5).*

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore të mësipërme, për këtë kandidate me më tepër se 3 (aplikime), qofshin këto për ngritje në detyrë dhe/ose lëvizje paralele të vlefshme do të konsiderohen ato të bëra më parë në kohë. Në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë do të konsiderohen të vlefshme ato kandidime që janë renditur sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura nga Këshilli, duke filluar nga ai i shpalluri më parë. Pra znj. {...} aplikime të vlefshme ka ato të ngritjes në detyrë për pozicionet nr. 500/2022, 501/2022 dhe 246/2023 dhe për të (ne mendojmë) që nuk duhet të fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për lëvizjen paralele pasi nuk ka pozicione të vlefshme në garë.

Në arritjen e këtij konkluzioni Komisioni ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin

Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2020-995, datë 28.12.2020, arsyetimi i asaj pjese që përkon me konkluzionet e Komisionit është i integruar në pjesën e relacionit.

Lidhur me kandidatin z. {...}, i identifikuar si kandidat i cili mund të ketë 2 (dy) vlerësime, edhe ai ndodhet (sipas mendimit tonë) në kushtet kur ka më tepër se 3 (tre) aplikime të vlefshme në proces. Z. {...} ka në garë pozicionin nr.14/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe për të ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për dy pozicione në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë pozicionet nr.244 dhe nr. 246.

Për këtë kandidat me më tepër se 3 (aplikime), qofshin këto për ngritje në detyrë dhe/ose lëvizje paralele të vlefshme do të konsiderohen (sipas vlerësimit të komisionit) ato të bëra më parë në kohë. Në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë do të vlefshme do të konsiderohen ato kandidime që janë renditur sipas radhës kronologjike të pozicioneve të pozicioneve të shpallura nga Këshilli, duke filluar nga ai i shpalluri më parë. Pra z. {...} aplikime të vlefshme ka ato të ngritjes në detyrë për pozicionet nr. 244/2023, nr. 246/2023 dhe pozicionin nr.14/2023 për lëvizjen paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të shpallur më parë. Si konkluzion, për të nuk do të fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për lëvizjen paralele pasi ky kandidat nuk ka pozicione të vlefshme në garë. Edhe për këtë kandidat vlen argumentimi në pikat 12-14 të këtij relacioni.

Kandidatja {...} ka më tepër se 3 (tre) aplikime në proces. Konkretisht ajo ka aplikuar në pozicionet nr.74, 82, 83, 84. Për arsyet e përmendura më sipër për këtë kandidate do të fillojë procedura e verifikimit vetëm për 3 (tre) kandidimet e vlefshme që i përkasin pozicioneve nr. 74, 82 dhe 83, duke përjashtuar atë që i përket pozicionit nr. 84.

Gjithashtu, edhe kandidati z. Nertil Dushku ka aplikuar në më shumë se 3 (tre) pozicione, konkretisht, nr. 75, 76 dhe 77 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe nr. 83 dhe 84 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kandidime të vlefshme të këtij kandidati do t'i konsiderohen tre të parat, që janë pozicionet me nr. 75, 76 dhe 77.

Në pozicionet nr. 84 dhe nr. 86 që i përkasin Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës vërehet se nuk ka në garë kandidatë që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. Për rrjedhojë për këto pozicione Këshilli duhet të vijojë me verifikimin për kandidatët që kanë ose që mund të kenë, pra që mund t'i bëhet një vlerësim.

Në Kreun IV të vendimeve respektive nr. 84 dhe nr. 86, datë 20.02.2024, Këshilli ka përcaktuar procedurën përkatëse që do të ndiqet si më poshtë:

Procedura është ajo e parashikuar në vendimet përkatëse. Kështu që unë nuk po kaloj. Është pjesë e integruar e relacionit, procedurë që i përket pozicioneve nr. 84 dhe nr. 86.

Këshilli në këtë rast, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim, me vendimin e datës 11.03.2024, ndër të tjera vendosi: "Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të përmendura më lart. Shtojca nr. II ka listën e gjyqtarëve që kanë një vlerësim si dhe listën e gjyqtarëve që mund t'u bëhet një vlerësim. Nuk po i përmend një nga një emrat e gjyqtarëve pasi ne i kemi miratuar bashkërisht dhe janë pjesë e shtojcës nr. 2 të vendimmarrjes së marrë nga Këshilli.

Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në Shtojcën II, rezulton se 6 (gjashtë) prej tyre kanë kandiduar në pozicionet nr. 84 dhe nr.86.

Përkatësisht, në pozicionin nr. 84, kandidon z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Pra është i vetmi që mund t'i bëhet një vlerësim në këtë pozicion.

Në pozicionin nr. 86 kandidojnë gjyqtarët {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër; {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë; {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë/ i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë/ caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83 dhe 85, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

Në pikën e dytë – caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 10 kandidatët të cilët sipas shtojcës I të vendimit të datës 11.03.2024, kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime: Znj. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Në pikën e tretë parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84 dhe 86, datë 20.02.2024 (sepse thamë që për këto dy pozicione mund të vijojë procedura vetëm për kandidatët që kanë ose që mund t'u bëhet një vlerësim).

Në pikën e katërt propozohet caktimi i relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 6 kandidatët të cilët sipas shtojcës II të vendimit të datës 11.03.2024, kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim: Z. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Z. {...},

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 16 (gjashtëmbëdhjetë) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurat e lëvizjes paralele. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 5 (pesë) kandidatë, ndërsa Kryetari i Komisionit caktohet relator për 6 (gjashtë) kandidatë.

Në vijim parashikohet edhe e drejta e ankimit për kandidatët të cilët sipas këtij

vendimi nuk kanë aplikime të vlefshme.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe të shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Mëqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në përgatitjen dhe hedhjen e shortit sipas mekanizmit të përcaktuar nga relatori.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi (për gjashtë kandidatë), z. Markelian Koça (për pesë kandidatë) dhe z. Alban Toro (për pesë kandidatë).

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime: znj. {...}, znj. {...}, z. {...} znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}; dhe kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Klodian Kurushi i cili do të jetë relator për gjashtë kandidatët e përzgjedhur sipas kësaj radhe: z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit z. Alban Toro i cili do të jetë relator për pesë kandidatët e përzgjedhur sipas kësaj radhe: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit z. Markelian Koça i cili do të jetë relator për pesë kandidatët e përzgjedhur sipas kësaj radhe: z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime mbi mënyrën e hedhjes së shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përditësuar edhe sipas rezultateve të shortit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1.Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83 dhe 85, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
2. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
3. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
5. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
6. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;

7. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Markelian Koça;
8. Për kandidatin z. {...} – relator z. Markelian Koça;
9. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
10. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.

3. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

4. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} – relator z. Markelian Koça;
2. Për kandidatin z. {...} – relator z. Markelian Koça;
3. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
5. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro;
6. Për kandidatin z. {...} – relator z. Markelian Koça;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 17 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.03.2024)

Pika 18 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës Online*:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Emona Muçi* (anëtare)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Irena Plaku* (anëtare)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)*

¹⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 19-ta sipas rendit të ditë dhe është përmbledhje.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, e cila u largua pas trajtimit të çështjes nr. 13.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*

6. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*

7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

18. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën e fundit të kësaj mbledhjeje plenare që ka të bëjë me shqyrtimin i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Klodian Kurushi.

Zoti Kurushi shkurtimisht parashtron se, deri më datë 12.03.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesat për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme dhe bëhet fjalë për tre çështje penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës bashkëlidhur relacionit). Bashkëlidhur relacionit janë edhe emrat e gjyqtarëve që kanë pengesë për të qenë pjesë e shortit.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin X/2 të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, por edhe referuar përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij Vendimi, në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

1. Për çështjet me numrin rendor 1 dhe 2 në tabelë, gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (një) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gjyqtarët për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4 (katër).

4. Për çështjen me numrin rendor 3 në tabelë, propozohet që duke qenë se është

çështje e ndarë nga i njëjti procedim penal me atë të çështjes nr. 75 akti, dhe kërkohet plotësimi i trupit gjykues për seancë paraprake, në pajtim me parashikimin K.Pr.Penale, përkatësisht neni 332/1 ku për përcaktohet se: “Kërkesat për dërgimin për gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”, do të caktohet gjyqtari i caktuar për gjykimin e kërkesës nr. 114, z. {...}.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si vijon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër. Gjithashtu edhe gjyqtarët e shortuar së fundmi dhe që kanë ngarkesë në GJKKKO: Z. {...}, pasi do caktohet në një gjykim tjetër dhe është caktuar edhe më përpara si dhe znj. {...} e cila është dy herë e caktuar në shortet e fundit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën nr. 910, gjyqtar i përzgjedhur z. Besmir Stroka.

Për kërkesën nr. 960, gjyqtarë të përzgjedhur znj. Luljeta Kole relatore, Rexhep Bekteshi dhe Edvan Veçani anëtarë.

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

